

VENDIM
Nr.805, datë 22.7.2009

**PËR KALIMIN E PRONËSISË SË PARCELAVE NDËRTIMORE, NË FAVOR TË
POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, të shkronjës "ç" të nenit 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të nenit 175 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të poseduesve të objekteve informale, të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore të zëna, sipas listës dhe planvendosjeve përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi, në:

- qarkun e Tiranës, 1875 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 590 161,75 (pesëqind e nëntëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e një presje shtatëdhjetë e pesë) m²;

- qarkun e Shkodrës, 25 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 7625 (shtatë mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) m²;

- qarkun e Beratit, 55 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 23 374,10 (njëzet e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër presje dhjetë) m²;

- qarkun e Gjirokastrës, 15 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 801,80 (tetëqind e një presje tetëdhjetë) m²;

- qarkun e Fierit, 120 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 31 872,70 (tridhjetë e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy presje shtatëdhjetë) m²;

- qarkun e Elbasanit, 234 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 37 630,67 (tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë presje gjashtëdhjetë e shtatë) m²;

- qarkun e Korçës, 8 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 1 141,51 (një mijë e njëqind e dyzet e një presje pesëdhjetë e një) m².

- qarkun e Durrësit, 382 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 151 109,30 (njëqind e pesëdhjetë e një mijë e njëqind e nëntë presje tridhjetë) m²;

- qarkun e Vlorës, 234 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 79 497,20 (shtatëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë presje njëzet) m²;

- qarkun e Kukësit, 16 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 1 553,93 (një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre presje nëntëdhjetë e tre) m²;

- qarkun e Lezhës, 47 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 20 228,22 (njëzet mijë e dyqind e njëzet e tetë presje njëzet e dy) m²;

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelave ndërtimore, të objekteve informale, nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

EVIDENCA E TË DHENAVE PËR KALIM PRONËSIE PËR VENDIMIN E KESHILLIT TË MINISTRAVE

Nr Rendor	Nr I qarqeve	Qarku	Nr. i zonave kadastrale/blloku	Nr. i parcelave të objekteve informale	Sip. parceles ndertimore per kalim pronsie (m²)
1	2	3	4	5	6
1	1	TIRANE	ZK 8320, 8120 Bll 6 Njesia Bashkiake Nr 4,11	3	1,380.50
2		TIRANE	ZK 8170 Bll 4 Njesia Bashkiake Nr 1,3	191	60,305.80
3		TIRANE	ZK 8330 Bll 2,3,6 Njesia Bashkiake Nr 9	85	25,466.70
4		TIRANE	ZK 8220 Bll 8 Njesia Bashkiake Nr 7	76	21,501.80
5		TIRANE	ZK 8190 Faza 2 Njesia Bashkiake Nr 2	742	259,981.00
6		TIRANE	ZK 8310 Faza 4 Njesia Bashkiake Nr 11	160	51,846.30
7		TIRANE	ZK 8320 Bll 6 Njesia Bashkiake Nr 11	56	20,440.40
8		TIRANE	ZK 8260 Bll 1,2,7 Njesia Bashkiake Nr 5	129	3,655.40
9		TIRANE	ZK 3321 Pjese e Fshatit Njesia Bashkiake Nr 6	199	68,741.30
10		TIRANE	ZK 8120 Bll 2,3,6,7 Njesia Bashkiake Nr 4	4	1,247.00
11		TIRANE	ZK 2460 Qesarake Komuna Dajt Bashkia Tirane	127	50,755.00
12		TIRANE	Zk82502 Bll nr 2 Njesia Bashkiake Nr 7(Shtesa (A1)	32	1,556.65
13		TIRANE	Zk82502 Bll nr 3 Njesia Bashkiake Nr 7	1	220.00
14		TIRANE	ZK 2460 Qesarake Komuna Dajt Bashkia Tirane	70	23,063.90
		Qarku Tirane		1875	590,161.75
15	2	SHKODER	ZK 8591 Bll 4,5,8,9,10 Bashkia Shkoder	25	7,625.50
		Qarku Shkoder		25	7,625.50
16	3	BERAT	ZK 8501 Bashkia Berat Nderetim I vecuar	1	500.20
17		BERAT	ZK 8503 Bashkia Berat Lagja Donika Kastrioti	1	300.00
18		BERAT	ZK 8503 Bashkia Berat ish Fushe e Pyllit	4	1,951.30
19		BERAT	ZK 8502 Bashkia Berat ish Fushe e Pyllit	4	1,385.00
20		BERAT	ZK 8501 Bashkia Berat Lagja D. Kombit	1	550.00
21		BERAT	ZK 3210 Bashkia Kucove	44	18,687.60
		Qarku Berat		55	23,374.10
22	4	GJIROKASTR A	ZK 8541 Bashkia Gjirokaster Shtesa (A1)	2	137.30
23		GJIROKASTR A	ZK 8541,8543 Bashkia Gjirokaster Shtesa (A1)	4	206.30
24		GJIROKASTR A	ZK 8543 Bashkia Gjirokaster Objekte te vecuara	2	198.00
25		GJIROKASTR A	ZK 2917 Bashkia Permet Shtesa (A1)	6	213.70
26		GJIROKASTR A	ZK 2917 Bashkia Permet Objekt I vecuar	1	46.50
		Qarku Gjirokaster		15	801.80
27	5	FIERI	ZK 8533 Bashkia Fier Lagjia 8 Shkurti	1	141.50
28		FIERI	ZK 8533 Bashkia Fier Lagjia 8 Shkurti Shtesa (A1)	5	227.10
29		FIERI	ZK 8532 Bll 17 Bashkia Fier Lagjia Sheq I Madh	3	970.40
30		FIERI	ZK 8534 Bll 10,11 Bashkia Fier Lagjia Afrim I ri	32	9,668.00
31		FIERI	ZK 8533 Bll 11Bashkia Fier, Mbrostar Ferko	18	5,400.00
32		FIERI	ZK 8572 Bll 5 Bashkia Lushnje, L.18 Tetori	24	6,504.80
33		FIERI	ZK 8534 Bll 1 Bashkia Fier Lagjia 16 Prilli	4	1,216.00
34		FIERI	Zk 8571 Bll 3 Bashkia Lushnje L. XH. Nepravishta	29	6,498.00
35		FIERI	Zk 8572 Bll 2 Bashkia Lushnje L. Clirimi	2	503.70
36		FIERI	ZK 8531 Bashkia Fier Lagjia 1Maji	2	743.20
		Qarku Fier		120	31,872.70
37	6	ELBASAN	ZK 2908 Bll 2 deri 17 Bashkia Pegin	27	6,947.10
38		ELBASAN	ZK 1842 Bll5 deri 10 Bashkia Gramsh	17	1,301.30
39		ELBASAN	ZK 2167 Bll53,70 Bashkia Gramsh	3	720.70
40		ELBASAN	ZK 8522 Bll 1 deri 12 Bashkia Elbasan	56	5,663.10

41		ELBASAN	ZK 1146,1147,3647 Bll 23 deri 275 Bashkia Belësh	6	1,470.70
42		ELBASAN	ZK 8523 Bll 3 deri 27 Bashkia Elbasan Shtesa (A1)	11	682.60
43		ELBASAN	ZK 1919 Komuna Shushice Bll 25	55	13,226.20
44		ELBASAN	ZK 1842 BLL 1 deri 10 Bashkia Gramsh	24	1,086.17
45		ELBASAN	ZK 2908 Bll 2 deri 17 Bashkia Peqin (Faza 2)	35	6,532.80
		Qarku Elbasan		234	37,630.67
46		KORCE	ZK 8562 Bashkia Korce Lagjia 4	1	100.00
47		KORCE	ZK 2573 Bashkia Maliq (ish Bonifikimi)	1	210.60
48		KORCE	ZK 2573 Bll 3 Bashkia Maliq Shtesa (A1)	1	55.50
49		KORCE	ZK 8563 Bashkia Korce Lagjia 5	1	101.22
50	7	KORCE	ZK 3664 Komuna Bucimas (fshati Tushemisht)	1	286.60
51		KORCE	ZK 1310 Komuna Bulgarec(Fshati Bulgarec)	2	219.60
52		KORCE	ZK 3664 Komuna Bucimas (fshati Tushemisht)	1	167.99
		Qarku Korce		8	1,141.51
53		DURRES	ZK 8517 Bashkia Durres Ish keneta	47	21,046.00
54		DURRES	ZK 8512 Bll 12 Bashkia Durres	1	411.00
55		DURRES	ZK 3369 Bashkia Shijak	2	696.00
56		DURRES	ZK 8517 Bashkia Durres Ish keneta	4	1,938.00
57		DURRES	ZK 2574 Komuna Rrashbull	6	3,555.00
58		DURRES	ZK 2574 Komuna Rrashbull Shtesa (A1)	3	129.00
59		DURRES	ZK 8517 Bashkia Durres Ish keneta	1	410.00
60		DURRES	ZK 8511 Bashkia Durres Ish keneta	23	8,130.00
61	8	DURRES	ZK 8517 Bashkia Durres Ish keneta	3	1,261.00
62		DURRES	ZK 8517 Bashkia Durres Ish keneta	87	30,496.00
63		DURRES	ZK 8517 Bashkia Durres Ish keneta	64	30,414.30
64		DURRES	ZK 8511 Bashkia Durres Ish keneta	56	20,152.00
65		DURRES	ZK 8511,8513,8515 Bashkia Durres	5	915.00
66		DURRES	ZK 8517 Bashkia Durres Ish keneta	7	3,077.00
67		DURRES	ZK 8511 Bashkia Durres Ish keneta	29	10,747.00
68		DURRES	ZK 8512 ,8513 Bashkia Durres (shtesa A1)	3	241.00
69		DURRES	ZK 8517 Bll 2 dhe 22 Bashkia Durres Ish keneta	41	17,491.00
		Qarku Durres		382	151,109.30
70		VLORA	ZK 8604 VL-M-10,VL-N-10,Bashkia Vlore	59	15,516.80
71		VLORA	ZK 8601,8602,8603,8604,8605, Bashkia Vlore	18	5,329.20
72	9	VLORA	ZK 8605 VL-E-11F-11,Bashkia Vlore	122	43,528.70
73		VLORA	ZK 8605 VL-E-9 ,Bashkia Vlore	35	15,122.50
		Qarku Vlore		234	79,497.20
74		KUKESI	ZK 2315 Bll 23 deri 46 Bashkia Kukes	12	1,354.22
75	10	KUKESI	ZK 2315 Bll 19 L1,Bll 33 L4,Bll 25 L5, B. Kukes (A1)	4	199.71
		Qarku Kukes		16	1,553.93
75		LEZHA	ZK 8632 Bll 8 Koder Marlekaj Baskhkia Lezhe	31	12,817.00
76	11	LEZHA	ZK 8631 Baskhkia Lezhe	16	7,411.22
		Qarku Lezhe		47	20,228.22
		SHUMA TOTALE			3,011 944,996.68